

Emri i Lëndës : Metodat e Kërkimit dhe Shkrimi Akademik							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 305	A	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori	Ramadan Cipuri, Prof. Asoc. Dr.						
Asistenti							
Gjuha e kursit	Shqip						
Niveli i lëndës	Bachelor						
Përshkrimi	Metodat e Kërkimit dhe Shkrim Akademik pohon se në të vërtetë me anë të këtij përcaktimi kuptohet një teori e nyjtuar, konceptet operative të së cilës përdoren për të nxënë njohuri që janë në funksion të zgjidhjeve të problemeve, të ndërtimit dhe përkufizimit të koncepteve për strategji zhvillimore, planifikim strategjik, për menaxhim efektiv. Metodat e Kërkimit dhe Shkrim Akademik ndihmojnë në përgatitjen e një punimi të mirë, që njëherazi mund të vlejë për të rifituar besimin në dobinë dhe vlerën përparimjellëse të të studiuarit, të kuptuar jo thjesht si grumbullim të dhënash, por si përpunim kritik i një përvoje, si fitim aftësie (të vlefshme për të ardhmen) për të zbuluar problemet, për t`i trajtuar në mënyrë metodike ato dhe për t`i parashtruar sipas disa mënyrave komunikuese të caktuara. Ky kurs ligjëratash ka për qëllim të shpjegojë se si mund të kryhet një studim që mbështetet në metodën e duhur, duke dhënë kështu ndihmesë teoriko-kritike-analitike rreth dobisë së të marrit me studime, por dhe do të udhëzojë e ndihmojë lidhur me mënyrën se si mund të punohet një punim konkret. Thënë më shkurt, programi përmban sasi të mjaftueshme të materialeve teorike, për t`i dhënë rëndësi të veçantë punës praktike, nga e cila krijohet një bazament i qëndrueshëm për të ndërtuar intelektualisht.						
Objektivat	Të marrë njohuri bazë mbi metodat e avancuara shkencore të kërkimit Të përvetësohen konceptet operative për të nxitur përvetësimin e njohurive që kanë të bëjnë me hartimin me shkathtësi, si një përgatitje modern, pa të cilën është vështirë të rreshtohen studentët në rrafshin e të kuptuarit, të interpretimit, të pavarësimit si dhe të daljes nga rrethi vicioz i kohës. Të arrijnë studentët që duke aplikuar instrumentët metodologjikë, të mundësojnë shqyrtimet teorike duke kaluar në veprime konkrete, në hulumtime, observime dhe hartime të punëve profesionale, si një hap për të hyrë në brendinë e shkencës. Kursi i ligjëratave Bachelor mundëson veprim origjinal, të pavarur, komunikim me vlerat e shkuara, si dhe të skicimit të ideve me performancë të dobishme për zhvillimin e tërësishëm të kulturës, si parakusht i gjithë zhvillimeve të tjera.						
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Ç'është kërkimi shkencor? Karakteristikat e kërkimit shkencor. Cilësia në kërkime shkencore.						
2	Dijet, teoritë paradigmë dhe këndvështrimet. Natyra e subjektit të kërkimit shkencor në shkencat sociale.						
3	Natyra e të dhënave. Karakteristikat e të dhënave. Përdorimi i të dhënave si përfaqësim i relitetit shoqëror.						
4	Pyetjet e kërkimit shkencor, hipotezat, përkufizimet operative të kërkimit shkencor.						
5	Planifikimi i një projekti kërkimi shkencor. Përkufizimi, aspekte praktike.						
6	Vlerësimi kritic i literaturës. Kërkimi i literaturës. Aspekte praktike të shqyrtimit të literaturës. Procesi i shqyrtimit të literaturës.						

7	Modelet e hulumtimit. Modeli cilësor dhe modeli sasior. Niveli dhe njësia e kërkimit shkencor. Strategjitë e kërkimit shkencor.
8	Provim Gjysmëfinal
9	Mbledhja e të dhënave. Pyetësorët, intervistat gjysëm të strukturuar.
10	Grupet e fokusit. Vrojtimi. Burimet dytësore të të dhënave.
11	Analiza e të dhënave. Tiparet e analizës. Analiza statistikore.
12	Analiza tematike. Puna me të dhëna cilësore. Analiza e rrëfimeve. Analiza e ligjërit. Analiza e përmbajtjes.
13	Shkrimi akademik, procesi i të shkruarit. Fusha e veprimit dhe karakteristikat e përdorimit.
14	Planifikimi dhe struktura e shkrimit akademik. Mënyra e të shkruarit
15	Sistemi i referencave. Plagjiatura.
16	Provim Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Bob Matthews, Liz Ross (CDE 2010). Metodot e Hulumtimit - Udhëzues Praktik për shkencat sociale dhe humane • Jill Lewis, Studimi akademik. CDE, 2005, Tiranë • Umberto Eco. Si shkruhet një punim diplome. Dituria. 2006. Tiranë	
Referenca të tjera	
• Roger D. Wimmer, Joseph R. Dominick. Mass Media Research	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Të aftësohet student në thellimin e njohurive shkencore dhe profesionale, si një lëmë i domosdoshëm dhe i patjetërsueshëm, për krijim, pavarësim dhe aftësim në kryerjen e punëve në lëmin e studimit dhe më gjerë.
2	Studenti duhet të kryejë punime me nivel të lartë shkencor (ese, detyra kursi, punime të tjera, punime diplome etj.)
3	Të nxitet të menduarit kritik duke u shfaqur në aktin e ndjeshmërisë së veprës si dhe të kuptuarit të saj.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	0	0	
Kuize	2	10	
Projekte	1	40	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	20	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			70
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			30
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	1	20	20
Gjysmë finale	0	0	0
Provimi final	1	15	15
Të tjera	1	20	20
Ngarkesa totale e orëve			131
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.24
ECTS			5.00